



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2025:020128

Datë: 11.03.2025

Numri i dokumentit: 06973406

P.nr.47/2025

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekalju, me pjesëmarrjen e praktikantes Mimoza Salihu, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.B nga fshati ..., nr..., komuna Vushtrri, për shkak të veprës penale *Vetëgjyqësi* nga neni 410 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.90/2025, të dt.04.02.2025, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me dt. 11.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm me nr. PP.II.nr.90/2025, të dt.04.02.2025, andaj gjykata konform dispozitës së nenit 493 të KPPK jep këtë:

U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

I akuzuari D.B, nga i ati B... dhe e ëma Sh..., e vajzërisë H..., i lindur me ... në fshatin ..., me vendbanim në fshatin ..., nr..., Komuna Vushtrri, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE: Me datë 14.01.2025 rreth orës 13:52, në fshatin ..., komuna Vushtrri, pikërisht në lokalit që gjendet në katin përdhese të shtëpisë, të cilin lokal i pandehuri e kishte dhënë në shfrytëzim

me qera bashkëshortit të të dëmtuarës, Sh.M për dy vite me kontratë, me mundësi vazhdimi edhe për dy vite të tjera, e në të cilin lokal nuk kanë punuar që nga data 10.12.2024 për shkak të një rasti penal që ka ndodhur aty në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit, i pandehuri D.B me dashje e në mënyrë arbitrare, e ushtron të drejtën që mendon se i takon, në vend që ti drejtohet organit kompetent, në atë mënyrë që në ditën kritike në derën e Restorant Gjelltove "...", vendos edhe një dry të ri përveç atij ekzistues, për të mos e hapur askush lokalin , duke i pamundësuar kështu të dëmtuarës F.M- si menaxhere e biznesit privat, që të hyjë në restorant në mënyrë që të tërheqë nga ky lokal faturat dhe dokumentacionet e tyre, dy kompjuterë si dhe arkën fiskale që kanë qenë brenda lokalit, për të cilat kanë pasur nevojë.

Me këtë ka kryer veprën penale *Vetëgjyqësi* nga neni 410 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform dispozitave të nenit 4, 7, 17, 38, 81 të KPRK-ës, si dhe bazuar ne nenet 449, 463, 493 të KPP-së, i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Me të cilën të pandehurit i behët me dije se ka kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën vepër penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do të shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

Obligohet i akuzuari qe ne emër te kompensimit te viktimave te krimi te paguaj shumen prej 30 euro, si dhe paushallin gjyqësor ne shume prej 90 euro, te gjitha këto në afat prej 15 ditësh duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet ne kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Departamenti i Përgjithshëm në Mitrovicë, ka ngritë aktakuzën me numër PP.II.nr.90/2025, të dt.04.02.2025, kundër të akuzuarit D.B nga fshati ..., komuna Vushtrri, për shkak të veprës penale *Vetëgjyqësi* nga neni 410 par.1 të KPRK-së.

Gjykatës i është propozuar që kundër të akuzuarit të lëshoj urdhërin ndëshkimor-vërejtje gjyqësore, me arsyetimin e besueshëm se nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura aktakuzës së prokurorisë, vërtetohet se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri ligjvënësi ka parashikuar dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë(6) muaj, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 dhe 494 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së, dhe konform dispozitave nga neni 495 par. 1 të KPPK-së, ashtu që mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkesat e lëndës, siç janë: Raporti fillestar i incidentit i datës 14.01.2025, Raporti i oficerit-policit hetues i datës 17.01.2025, Procesverbali i marrjes në pyetje të dëmtuarës F.M i datës 14.01.2025, Procesverbali i marrjes në pyetje të pandehurit D.B i datës 14.01.2025, për këtë edhe i shqiptoi urdhër ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e vwrjetjes gjyqësore për të pandehurin në përputhje me nenin 82 par. 2 të KPRK-së, duke i bërë me dije kështu të njëjtit se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën veprën penale dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do të shqiptojë një sanksion më të rëndë penal.

Po ashtu, gjykata mori parasysh edhe faktin se për veprën penale e cila të pandehurit me aktakuzë i vihet në barrë, parashihet dënim me gjobë ose me burgim deri në gjashtë(6) muaj, dënim ky për të cilin lejohet shqiptimi i vërejtjes gjyqësore në raport me rrethanat ekzistuese të rastit konkret. Me rastin e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore, gjykata morri parasysh qëllimin e shqiptimit të këtij sanksioni, duke vlerësuar se edhe me këtë sanksion do të arrihet qëllimi i sanksionit penal nga neni 38 të KPRK-së, andaj të pandehurit i shqiptoi sanksionin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata çmon se shqiptimi i një sanksioni të tillë është i mjaftueshëm për të ndikuar në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe në rehabilitimin e të njëjtit, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e mori në bazë të nenit 449 dhe 452 të KPPK-së, ndërsa vendimin mbi kërkesën pasurore juridike gjykata e mori në bazë të nenit 462 par.2 të KPP-së

Me sa u tha më lartë në kuptim të nenit 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal

P.nr.47/2025, dt.11.03.2025

Praktikantja
Mimoza Salihu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Naim Rekalio

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet kundërshtim në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, gjyqtarit individual të kësaj gjykate.